



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

A.nr. 765/2016

Nazmi Fazliu

lidhur me

të drejtën në jetë dhe detyrimet pozitive për hetime efektive

Drejtuar :

Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror
Prokuroria e Shtetit

Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Prishtinë, 14 shtator 2017

Qëllimi i raportit

Raporti trajton të drejtën elementare në jetë, të garantuar me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare të inkuorporuara brenda të njëjtës. Në rastin e z. Nazmi Fazliu (këtu e tutje referuar si: ankuesi) e drejta për jetën pretendohet të jetë shkelur në rast të neglizhencës së personelit mjekësor brenda Qendrës Klinike Universitare, dhe mos veprimi efektiv të prokurorisë së shtetit.

Në bazë të asaj që u tha më lart, ky Raport do të shqyrtojë gjendjen faktike të rastit të parashtruar nga ankuesi, dhe do të paraqes analizë ligjore për shkeljen potenciale të të drejtës në jetë duke analizuar legjislacionin vendor, dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (këtu e tutje referuar si: GJEDNJ), në mënyrë që të tërheq vërejtje ndaj (mos)veprimeve të organeve shtetërore ndaj mbrojtjes së të drejtës në jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Në pajtim me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (këtu e tutje referuar si: Kushtetuta), Avokati i Popullit: *“mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”*. Në pajtim me këtë dhe paragrafin 3 të këtij neni: *“Çdo organ, institucion apo autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”*.
2. Më tutje, Ligji Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (këtu e tutje referuar si: Ligji për Avokatin e Popullit) në nenin 16 par.1 përcakton që i njëjti ka: *“kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljet e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit”*.
3. Po ashtu, në bazë të nenit 16 par.4: *“Avokati i Popullit ka kompetencë që të bëjë hetime gofë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”*.
4. Për më tepër, bazuar në nenin 18, par.1.1 Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit, dhe të angazhohet për eliminimin e tyre”* si dhe në pajtim me par. 1.2. *“të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla..”*.

Përshkrimi i çështjes

5. Hartimi i këtij Raporti është rezultat i ankesës së pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), nga *ankuesi* kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Prokurorisë Themelore (PTH) në Prishtinë, përkitazi me pretendimet për trajtim të pandërgjegjshëm mjekësor, mospërcaktim të saktë të shkakut të vdekjes me autopsi mjeko ligjore, si dhe për hetime joefektive, lidhur me rastin e bashkëshortes së tij, të cilës gjatë trajtimit me transfuzion të gjakut i ishte komplikuar gjendja dhe me 24 janar 2016, kishte ndërruar jetë.

Rrethanat e rastit

6. Faktet e vërtetuara bazohen në pretendimet e ankuesit, dokumente mjekësore të shoqëruara me fotografi gjatë trajtimit të rastit në QKUK, raportin e autopsisë MA 16-019, të datës 25 janar 2016, deklarata të personelit shëndetësor lidhur me ngjarjen, procesverbale dëshmitarësh të intervistuar nga policia, kallëzime penale të policisë, raporte policore, komunikime shkresash ndërmjet ankuesit dhe autoriteteve përgjegjëse, mendime profesionale, raporte profesionale, si dhe në bazë të informatave të tjera që Avokati i Popullit i ka në dispozicion, të cilat mund të paraqiten si më poshtë:
7. Ankuesi në ankesën e paraqitur me shkrim në IAP deklaroi: *“Ankohem kundër tri institucioneve të cekura më lart, për neglizhencë dhe mosveprim lidhur me rastin e vdekjes së bashkëshortes me datën 24 janar 2016, në QKUK. Kërkoj nga Avokati i Popullit që të angazhohet në lidhje me këtë rast pasi që kanë kaluar 10 muaj dhe është duke u zvarritur lënda, me qëllim të fshehjes së vërtetës ku në lëndë-dëshmi ka fakte videoinqizime ku vërehet se institucionet shëndetësore janë duke u munduar që ky rast të mos dalë në gjykim”.*
8. Nga fletëlëshimi me epikrizë, i Klinikës së Gjinekologjisë dhe Obstetrikës (KGJO) (*pa nr.protokolli, datë 20 janar 2016*) shihet se pacientja S.F., ishte pranuar në Repartin e Konzervativës me 20 janar 2016, në ora 14:00, me qëllim të përgatitjes preoperative për intervenimin kirurgjik (*miomectomy*), pasi që S.F. kishte anemi dhe duhej të merrte së paku dy doza gjaku. Nga ky fletëlësh shihet se pacientes S.F. i ishin siguruar dy doza të gjakut dhe një dozë plazmë dhe derisa ishte duke e marrë gjakun, pa e përfunduar dozën e parë S.F. kishte filluar të ankohej në ethe dhe gjendja e saj ishte përkeqësuar duke u manifestuar me zbeheje, semisomnolencë. Si pasojë e përkeqësimit të gjendjes S.F. nga KGJO ishte transferuar në Klinikën e Emergjencës me diagnozën e vendosur nga neurologu: *“Syndroma acute cerebrale - Coma”.*

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

9. Më 29 nëntor 2016, Avokati i Popullit shqyrtoi ankesën dhe vendosi të zhvillohen hetime, duke krijuar kështu lëndën me numër *A.nr.765/2016*.
10. Më 12 dhjetor 2016, IAP u njoftua se ankuesi kishte dyshime në veprimet hetimore të prokurorit të rastit (*Lënda PP.I.Nr.367/2016*) me pretendime se zvarritja e hetimeve është pasojë e ndikimeve të personave me ndikim (*familjarë të të dyshuarve*), prandaj i njëjti ka parashtruar kërkesë për përjashtimin e prokurorit të rastit e më pas ka paraqitur atë pranë Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD).

11. Më 19 janar 2017, përfaqësuesi i IAP-së u takua me kryeprokurorin e PTH në Prishtinë, me të cilin bisedoi përkitazi me çështjen e ankuesit. Kryeprokurori i PTH në Prishtinë deklaroi se prokuroria me 25 gusht 2016, ka kërkuar nga QKUK edhe një ekspertizë në lidhje me shkakun e vdekjes së pacientes S.F., ndërsa me 21 dhjetor 2016, ka pranuar ekspertizën nga ekipi i ekspertëve gjinekolog të QKUK-së, bashkë me mendimin profesional Nr.2023/2, të datës 16 dhjetor 2016, në bazë të të cilit arrihet përfundimi që pacientja ishte trajtuar konform rregullave shëndetësore. Në pikën 8 të këtij mendimi profesional theksohet që: *“Bazuar në të gjitha raportimet e specialistëve të lëmive tjera të përfshirë në rast, vlerësohet se kemi të bëjmë, sipas të gjitha gjasave me sindromen posttransfusive, si pasojë e pranisë së antitropave anti-Kelli (vlerësim nga ana e transfuziologut)”*.
12. Ditën e njëjtë përfaqësuesi i IAP-së u njoftua me faktin që lënda PP.I.Nr.367/2016, bazuar në gjendjen faktike më lart, nuk i ishte ndarë në punë asnjërit nga prokurorët përkundër faktit që gjatë muajve, maj, qershor dhe korrik 2016, zyrtarët policorë kanë deponuar në prokurori procesverbale të dëshmitarëve dhe kallëzime penale kundër punëtorëve shëndetësorë të implikuar në rast.
13. Më pas, përfaqësuesi i IAP-së u takua me njërin nga inspektorët e ZPD-së, nga i cili u njoftua se ata e kishin inspektuar rastin sipas parashtresës së ankuesit dhe nga PTH në Prishtinë kishin marrë konfirmimin se kërkesa e ankuesit për largimin e prokurorit nga rasti është aprovuar dhe sipas tyre lënda i është ndarë në punë një prokurori tjetër.
14. Po ashtu, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me ekspertin mjeko-ligjor, të DML përkitazi me rastin e ankuesit, i cili e njoftoi përfaqësuesin e IAP-së se nga dokumentacioni mjekësor vërtetohej se e ndjera F.S. gjatë një periudhe treditore i kishte marrë mbi 26 shishe të gjakut dhe produkte të gjakut, megjithatë fokusi duhej të vihej në mangësi të raportit të autopsisë. Në pajtim me këtë, ekspertiza e hartuar nga komisioni i mjekëve të QKUK-së ishte e domosdoshme.
15. Më 1 mars 2017, IAP u njoftua se PTH në Prishtinë i kishte ndarë në punë lëndën PP.I.Nr.367/2016, prokurorit përkatës, i cili kishte filluar me ndërmarrjen e veprimeve hetimore, kishte lëshuar aktvendim për fillimin e hetimeve dhe kishte filluar me intervistimin e të dyshuarve.

Korniza ligjore

16. Kushtetuta garanton të drejtat dhe liritë themelore, në bazë të nenit 21 par.1 si vijon: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”*. Në pajtim me këtë e në bazë të par.2 të këtij neni: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë”*.
17. Nga ajo që u tha më lart por edhe në pajtim me nenin 22 derivon zbatimin i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare: *“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*

[...]

(2) *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut*". [...]

18. E drejta për jetën, garantohet me nenin 25: të Kushtetutës "*Secili individ gëzon të drejtën për jetën*".
19. Interpretimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (këtu e tutje referuar si: KEDNJ) bëhet në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas nenit 53 të Kushtetutës: "*Te drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".
20. Në pajtim me atë që u tha më lart e në qëllim të theksimit të së drejtës së garantuar për jetë, në pajtim me nenin 56 të Kushtetutës mbi të drejtat dhe liritë themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme: "*Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet...(25)..., të Kushtetutës nuk është e lejuar në kufarë rrethanash*".
21. Më tutje, paragrafi 1, i nenit 4, i Ligjit Nr.2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor (këtu e tutje referuar si: Ligji për Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor), në mënyrë eksplicite përcakton që: "*Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë [...]*".
22. Në lidhje me paragrafin paraprak, Ligji Nr. 02/L-101 për Transfuzionin e Gjakut, Kontrollin e Gjakut dhe Produkteve të tij (këtu e tutje referuar si: Ligji për Transfuzionin e Gjakut), në nenin 24 thotë: "*Sigurimi i kualitetit në përdorimin e gjakut dhe komponentëve të gjakut mjekët që përdorin gjakun dhe komponentët e gjakut për mjekimin e pacientëve, në pajtueshmëri me praktikën e mirë klinike, do të sigurojnë:*
 - a) *përdorimin racional dhe të kualitetit të lartë;*
 - b) *e ruajnë dokumentacionin e përshkruar, fletë-kërkesat;*
 - c) *shënojnë efektet e mira – të dobishme, dhe efektet negative si dhe*
 - d) *ndërmarrin masat tjera të nevojshme*"
23. Neni 6 i Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (këtu e tutje referuar si: Kodi i Procedurës Penale), në paragrafin 3 parasheh fillimin e procedurës : "*Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit*".
24. Ligji Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore në paragrafin 1.2, të nenit 2 përcakton: "*Autopsia Mjeko Ligjore është procedurë e ekzaminimit mjeko ligjor që konsiston në ekzaminimin e jashtëm dhe të brendshëm të kufomës apo të mbetjeve mortore për përcaktimin e shkakut, mekanizmit, mënyrës së vdekjes, dhe rrethanave të tjera që kanë të bëjnë me vdekjen*", ndërsa neni 5 përcakton: "*Autopsia mjeko ligjore, në pajtim*

me ligjin dhe dispozitave përkatëse, kryhet por nuk kufizohet në këto raste: [...] dyshimi në mjekim të pandërgjegjshëm [...]”.

Analiza Ligjore

25. E drejta për jetën është listuar si e para në katalogun e të drejtave dhe lirive të njeriut të mbrojtura me KEDNJ për faktin që është *e drejtë më bazike* nga të gjithat. Ajo që dëshmon këtë fakt është edhe pamundësia në derogimin e kësaj të drejtë, qoftë edhe në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Praktika e GJEDNJ-së nisët prej lëndës McCann dhe të tjerët kundër MB¹ ku: *e drejta për jetën, sidomos në lidhje me nenin 3 të Konventës (Ndalimi i torturës), paraqet një nga vlerat më bazike të shoqërisë demokratike.*
26. Neni 2 i Konventës paraqet detyrat e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshin aspektet **pozitive dhe negative**: a) **obligimin pozitiv** për ta mbrojtur jetën dhe b) **obligimin negativ** që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të **parandalimit dhe hetimit**. Detyrimi i **parandalimit**² i obligon qeveritë e shteteve t’i pengojnë dhe luftojnë veprat penale. Nëse vërtetohet që qeveritë kishin njohuri, ose do to duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat sipas një vlerësimi të arsyeshëm mund të priteshin në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.
27. Neni 2 i Konventës, gjithashtu ia imponon detyrimin shtetit për t’i hetuar incidentet vdekjeprurëse duke përcaktuar që elementet kyçe të hetimit në përputhje me nenin 2 të jenë: *inicimi nga ana e shtetit; që të jetë i pavarur, efektiv, i shpejtë; si dhe që të jetë hapur për publikun dhe të përfshijë familjarët dhe të afërmit e viktimës. Përveç kësaj, shteti duhet të garantojë ekzistencën e një sistemi gjyqësor që*³:
- a) *Heton me iniciativën e tij rastet e vdekjeve, aty ku ka ndonjë provë që janë përfshirë palë të treta, edhe pse nuk është vënë në diskutim kryerja e ndonjë shkelje nga agjentët e Shtetit*⁴;
 - b) *Ka aftësinë të vërtetojë faktet dhe shkakun e vdekjes, të verë përpara përgjegjësisë ata që janë në faj, dhe t’i sigurojë viktimës dëmshpërblim të përshtatshëm;*

¹ McCann and others v UK e datës 27 shtator 1995; gjetur në:

[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["18984/91"\],"itemid":\["001-57943"\]};](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

² Osman v The United Kingdom e datës 28 shkurt 1998, gjetur në:

<file:///C:/Users/Ideapad/Downloads/001-58257.pdf>;

³ Ciechonska v Poland e datës 14 qershor 2011, gjetur në: <http://echr.ketse.com/doc/19776.04-en-20110614/vieë/>; Railean v Moldova e datës 28 qershor, 2010, gjetur në: :

<http://echr.ketse.com/doc/23401.04-en-20100105/vieë/>; dhe Dodov v Bullgaria e datës 17 prill 2008, gjetur

në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["dodov v bulgaria"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-84438"\]};](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

⁴ Rantsev v Cyprus and Russia e datës 10 maj 2010, gjetur në:

[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["rantsev v cyprus"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-96549"\]};](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

- c) *I mundëson çdo shtetasi të kërkojë një hetim të pavarur dhe efektiv mbi rrethanat e vdekjes, pavarësisht nga përfshirja e shtetit;*
- d) *Mund të përcaktojë përgjegjësinë civile për vdekjet, përfshirë edhe rastet që nuk kanë të bëjnë me fajësinë e Shtetit, p.sh. vdekjet e shkaktuara nga neglizhenca mjekësore apo nga aksidentet rrugore.*

28. Në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, fushëveprimi dhe natyra e detyrës që të hetohen incidentet mortore/fatale janë të shpjguara, në veçanti, në lëndën *Tanrikulu kundër Turqisë*⁵. GJEDNJ ka vlerësuar që obligimi që të hetohen rastet e vdekjes nuk ka të bëjë vetëm me rastet për të cilat përgjegjës kanë qenë zyrtarët e shtetit, por të gjitha ato raste për të cilat autoritetet kanë qenë të informuara. Autoritetet janë të obliguara të ndër marrin hapa të arsyeshëm dhe të domosdoshëm që të sigurojnë prova relevante (përfshirë edhe dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe provat e forenzikës), në mënyrë që hetimi të jetë i dobishëm dhe efikas. Prandaj, dështimi për t'u vazhduar rrjedha e qartë e ekzaminimit gjatë hetimeve mund të çojë në konstatimin e një shkeljeje të nenit 2. Në të vërtetë, GJEDNJ erdhi në konstatimin që: *“Çdo mangësi gjatë hetimit që e dëmton mundësinë për ta identifikuar autorin ose autorët e veprës kriminale do të jetë në rrezik të shkeljes së këtij standardi”*.

29. Duke u nisur nga rasti Erikson kundër Italisë⁶ e në lidhje me analizën ligjore të rastit në fjalë, nuk mund të anashkalohet vendimi i GJEDNJ-së në këtë rast ku theksohet që: *“obligimi pozitiv i shtetit të mbrojë nenin 2 të Konventës përfshinë edhe kërkesën ndaj spitaleve të kenë rregulla mbi mbrojtjen e jetës të pacientëve të tyre dhe të themelojnë një sistem efektiv që do mundësonte vërtetimin e shkakut të vdekjes deri tek e cila vjen gjatë qëndrimit në spital, si dhe përgjegjësinë e stafit mjekësor të përfshirë”*. Në lidhje me këtë duhet cekur edhe që: *“atëherë kur agjentët e shtetit potencialisht mbajnë përgjegjësinë mbi humbjen e jetës, hetimi i mirëfilltë duhet kryer, në mënyrë që faktet të bëhen publike, sidomos ndaj të afërmeve të viktimës”*.⁷

30. . Për më tepër, prokuroria do të duhej të kryente hetim efektiv, mbledhjen e shpejtë të fakteve, si dhe qasjen ndaj publikut dhe të afërmeve të viktimës, që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së janë kritere mbi të cilat shtrihet një hetim i mirëfilltë. Në pajtim me këtë, nuk mund të konkludohet tjetër përveç që shteti ka shkelur të drejtën për jetën në rastin e bashkëshortes së ankuesit. Kjo për faktin që: *“Qëllimi esencial i hetimit të mirëfilltë është që të sigurohet implementimi efektiv i legjislacionit vendor që mbron të drejtën në jetë si dhe, në rastet kur janë të involvuara organet e shtetit, të sigurojë përgjegjësinë e tyre për vdekjet që ndodhin nën përgjegjësinë e tyre”*.⁸

31. Më tutje, legjislacioni vendor, konkretisht Ligji për Transfuzionin e Gjakut përcakton nevojën e sigurisë dhe kualitetit në përdorimin e gjakut dhe komponentëve të gjakut për

⁵ *Tanrikulu v Turkey*, e datës 8 korrik 1999, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["tanrikulu v turkey"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-58289"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{);

⁶ *Erikson v Italy*, e datës 26 tetor 1999, gjetur në: <http://echr.ketse.com/doc/37900.97-en-19991026/view/>;

⁷ *Erikson v Italy*, e datës 26 tetor 1999, gjetur në: <http://echr.ketse.com/doc/37900.97-en-19991026/view/>;

⁸ *Angueova v Bulgaria*, e datës 13 shtator 2002, gjetur në: <file:///C:/Users/Ideapad/Downloads/001-60505.pdf>; dhe *Jasinskis v Latvia*, e datës 21 shkurt 2010, gjetur në: <file:///C:/Users/Ideapad/Downloads/001-102393.pdf>;

mjekimin e pacientëve, në pajtueshmëri me praktikën e mirë klinike, me ç'rast nga personeli shëndetësor kërkohet të sigurojnë përdorimin racional dhe të kualitetit të lartë të gjakut, të ruajë dokumentacionin e përshkruar (fletëkërkesat), të shënojë në dokumentacionin përkatës efektet e mira dhe efektet negative të gjakut. Po ashtu kërkon që institucionet spitalore, bazuar në Statutet e tyre, të themelojnë “Komitetet Spitalore Transfuzive” të cilat duhet të përbëhen nga specialistë të mjekësisë transfuzive dhe specialistët tjerë klinik të cilët mundësojnë zbatimin e aktiviteteve të rëndësishme transfuzive në spitale. Ligji nuk përcakton qartë situatat se si duhet vepruar në rast të përballjes me efekte negative sikur në rastin e ankuesit, prandaj nga analiza e këtij rasti shihet qartë se hudhja e qeses së gjakut (e cila në procedurat e mëvonshme rezultoi se ishte dëshmia kryesore për të sqaruar plotësisht zhvillimet e komplikimeve të rastit) ka kontribuar në krijimin e një situatë konfuze pasi që mungesa e së njëtës e pamundësoi sqarimin e plotë të rrethanave të rastit.

32. Për më tepër, Ligji për Transfuzionin e Gjakut në situatat kur gjatë përdorimit të gjakut apo komponentëve të gjakut, zënë fill efektet e padëshiruara (anësore), kërkon nga mjeku ordinar të lajmërojë menjëherë personin përgjegjës në spital, i cili në pajtim me praktikën e mirë klinike, do të duhej **menjëherë të lajmëronte institucionin e autorizuar transfuziv**. Nga shkresat e lëndës së këtij rasti (kallëzimi penal 2016-AD-0227, datë 20 korrik 2016 dhe raporti i autopsisë MA 16-019, datë 25 janar 2016) shihet qartë se nuk janë zbatuar dispozitat e këtij ligji, sepse konsultimi me transfuziologun nga ana e personit përgjegjës kishte ardhur në veprim tek ditën e nesërme, e jo menjëherë pasi janë shfaqur reaksionet e para me komplikacione, pas marrjes së gjakut nga ana e pacientes F.S.
33. Këtu duhet marrë parasysh edhe përgjegjësinë e personit juridik për vepra penale, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr.04/L-030 për Përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale (këtu e tutje referuar si: Ligji për Përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale). Me këtë ligj përcaktohet se personi përgjegjës është personi fizik brenda personit juridik, në pajtim me nenin 2 (1.1), i cili *“ka besimin për kryerjen e detyrave të caktuara, ose autorizimin për të vepruar në emër të personit juridik si dhe ekziston besueshmëria e lartë se është i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik”*. Po ashtu, më tutje në paragrafin 1.2. përcaktohet që si person juridik përkufizohet: *“subjekti juridik i vendit apo i huaj, i cili sipas legjislacionit Kosovar në fuqi konsiderohet si person juridik”*. Duke marrë parasysh këtë, duhet të vihet theksi mbi faktin që legjislacioni i Kosovës nuk definon personin juridik *per se* por një gjë të tillë ia lë jurisprudencës të determinojë me saktësi⁹.
34. Në lidhje me atë që u tha në paragrafin paraprak, Ligji Nr.04/L-125 për Shëndësi (këtu e tutje referuar si: Ligji për Shëndetësi) përcakton institucionin shëndetësor si: *“institucionin e themeluar nga personi fizik ose juridik që ofron shërbime të kujdesit shëndetësor, në bazë të licencës së lëshuar në pajtim me këtë Ligj”*; përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (këtu e tutje referuar si: Statuti i

⁹ Avni Puka, *Pranimi i përgjegjësisë penale të personave juridikë në sistemin “civil law” – një vështrim i legjislacionit të Kosovës*; Revistë shkencore juridike Opinio Juris, nr.1/2015; fq.60

SHSKUK-së) në nenin 4 përcakton SHSKUK-në si: “*person juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të veçanta për zbatimin e Ligjit për Shëndetësi, akteve të tjera përkatëse nën-ligjore të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë*”. Bazuar në këtë, rrjedh që SSHKUK është person juridik në bazë të Ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë, dhe që përgjigjet po ashtu në bazë të dispozitave të këtij Ligjit, për dëmin e shkaktuar nga personi apo personat fizik të punësuar aty, konkretisht për dëmet e shkaktuara nga stafi mjekësor, kur veprojnë si në pajtim me gjendjen faktike të përshkruar më lart.

35. Së fundmi, e në pajtim me atë që u tha më lart, Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (këtu e tutje referuar si: Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve), në nenin 152 përcakton përgjegjësinë e punëdhënësit, duke thënë që: “*personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkaktimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethana konkrete*”. Më tutje, ky nen në paragrafin 2 përcakton që: “*Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje*”. Nga kjo që u tha, është e qartë që ankuesi ka të drejtë, në bazë të legjislacionit në fuqi, të kërkojë përgjegjësi nga personi juridik, në këtë rast SSHKUK për dëmin e shkaktuar nga personeli mjekësor, i përshkruar në paragrafët më lart që i referohen gjendjes faktike të rastit.
36. Nga ajo që u tha më lart, duke marrë parasysh edhe dispozitat relevante të Kodit Penal mbi hetimin e rasteve të këtilla, rrjedh që legjislacioni vendor është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sipas analizës së paraqitur më lart, e drejta për jetë e mbrojtur me anën e KEDNJ-së mbrohet në tërësi edhe në bazë të legjislacionit të Kosovës. Situata në terren, e që rrjedh edhe nga gjendja faktike e këtij rasti e përshkruar më lart, tërheq vërejtjen mbi shkeljen e së drejtës në jetë, për shkak të veprimit të dëmshëm të stafit mjekësor që tërheq përgjegjësinë e personit juridik, si dhe jo efikasitetit të hetimit që udhëhiqet nga prokurorisë, e që është kusht për implementimin e plotë të mbrojtjes së të drejtës për jetë në bazë të praktikës së GJEDNJ-së.
37. Praktika gjyqësore e GJEDNJ, rekomandon se duhet të shfrytëzohen të gjitha mjetet juridike në dispozicion, edhe atëherë kur pala nuk beson që të njëjtat mund të jenë të efektshme apo të prodhojnë rezultat të drejtë për palën¹⁰. Në të kundërtën, mosshfrytëzimin e të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, GJEDNJ nuk e trajton si shkelje të nenit 2, përveç nëse nuk është e qartë që mjetet e tilla juridike nuk kanë mundur të adresojnë çështjet e shtruara faktike apo ligjore.¹¹ Shterja e mjeteve juridike nënkupton edhe procedurën civile ku mund të kërkohet kompensimi i dëmit jo material por i cili, në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, përjashton mundësinë e hetimit të

¹⁰ Erikson v Italy, e datës 26 tetor 1999, gjetur në: <http://echr.ketse.com/doc/37900.97-en-19991026/view/>; dhe Powell v United Kingdom, e datës 4 maj 2000, gjetur në:

¹¹ Douwe Korff: A guide to implementation of Article 2 of the European Convention on Human Rights, Nëntor 2006, gjetur në: <https://rm.coe.int/168007ff4e>, fq.80.

mëtutjeshëm mbi rrethanat e vdekjes së personit, rasti Powell kundër MB: “Kur i afërmi i personit të vdekur pranon kompensim të dëmit përmes padisë civile mbi neglizhencën mjekësore, ai apo ajo nuk ka të drejtë të konsiderohet viktimë në lidhje me rrethanat mbi trajtimin e të ndjerit apo të kërkojë hetime të mëtutjeshme në lidhje me vdekjen e tij/saj”.¹²

38. Duke u nisur nga çka u tha më lart, Avokati i Popullit

REKOMANDON

Prokurorinë Themelore në Prishtinë që:

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, si dhe në bashkëpunim me të gjitha agjencitë relevante të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e hetimeve të shpejta dhe efektive në çështjen e ankuesit, duke i zbardhur të gjitha rrethanat dhe shkaktarët e vdekjes së bashkëshortes së ankuesit.
- Të vlerësohet përgjegjësia duke përfshirë përgjegjësinë objektive dhe subjektive e që do të mund të lehtësonte çështjen e kompensimit për palën.

Ministrinë e Shëndetësisë që:

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të themelojë komision të posaçëm për vlerësimin e gjendjes, i cili pas vlerësimit të situatës në terren do të hartonte protokol pune me rregulla strikte për rastet e dhënies së transfuzionit të gjakut.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

¹² Powell v United Kingdom, e datës 4 maj 2000, gjetur në:
[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["45305/99"\]}::;](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)